

Syllabusi i lëndës

Lënda: Hyrje në Filozofi të përgjithshme dhe atë islame

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 6

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 210

Fondi i orëve: 3+2

Viti akademik: 2015/2016

Semestri: IV

Mësimdhënësi: Prof. ass. dr. Zija Abdullahu

Përshkrim i shkurtër i lëndës

Studimi përmban bazat e filozofisë, botëkuptimet e saj te popujt e ndryshëm, raporti i saj me shkencat tjera, proceset e zhvillimit filozofik që nga paraqitja e deri në ditët e sotme, si dhe raportin e saj me shkencat tjera. Filozofët më eminent të filozofisë së përgjithshme dhe ata islam. Tematikat më kryesore të filozofisë, e në veçanti tematikat e filozofisë islame të frymëzuara nga filozofia kuranore. Të ngjashmet dhe dallimet ndërmjet rrymave filozofike të ndryshme, e me theks të veçantë atë islame.

Qëllimi i lëndës

Pajisja e studentëve me njohuri bazë nga lëmi i Filozofisë, në përgjithësi dhe asaj islame në veçanti. Studenti do t'i hulumtojë dhe studiojë bazat e filozofisë, botëkuptimet e saj te popujt e ndryshëm, si dhe në periudha të ndryshme të historisë së saj, raporti i saj me shkencat tjera, si dhe temat më kryesore të filozofisë. Zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive për të analizuar të dhënat e koncepteve të ndryshme filozofike të cilat përfshin programi studimor në mënyrë, që të mund të nxjerr konkluzione për to. Fitimi dhe avancimi i sensit kritik në aspektin e vlerësimit të argumenteve bazuar në fakte përkatëse filozofike. Aftësimi për të shkruar ese apo për të diskutuar për tema të ndryshme filozofike, në një stil të pastër dhe bindës në të shprehurit me gojë dhe me shkrim, tipare këto të një personi me një edukim liberal akademik. Prej leksioneve nga Filozofia presim që studentit pas përfundimit të këtij kursi do të përfitojë kulturë të përgjithshme për tematikat filozofike më kryesore gjatë historisë dhe në të tashmen, me theks të veçantë për tematikat e filozofisë islame të frymëzuara nga filozofia kuranore. Të kuptojë proceset e zhvillimit filozofik që nga paraqitja e saj e deri në ditët e sotme. T'i jepet mundësi studentit që në formë kritike duke nxitë debate, të bëjë krahasimin e rrymave të ndryshme filozofike, për të zgjedhë atë më të përshtatshëm për vendin tonë. Të kuptojë se zhvillimi i filozofisë

është një çështje e pandalshme dhe kërkon kontribut të secilit brez për të arritur në njohuri sa më të shëndosha, dhe në këtë mënyrë të avancohet sa më tepër jeta shoqërore.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

Të përshkruaj etapat e zhvillimit të filozofisë gjatë historisë antike si dhe asaj moderne.

Të krahasoj ndërmjet rrymave të ndryshme filozofike të cilat i studion gjatë kursit.

Të diskutoj rreth tematikave filozofike në bazë të argumenteve të tyre, duke arritur në konkluzione sa më të qarta dhe të jetë sa më objektiv.

Të mbroj qëndrimet e rrymave të ndryshme filozofike, ashtu siç i konceptuan themeluesit e tyre.

Të parashtroj mendimin kritik ndaj secilës prej tyre, duke përfunduar në atë me argumente më të shëndosha.

Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikoj në relacionin ndërshoqërorë

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, me anë projektorit, i cili i ndihmon studentët që ta kuptojnë edhe më qartë ligjëratën, stimulimit të tyre në diskutime interaktive, duke bërë pyetje dhe analiza në kuadër të ligjëratës së mbajtur. Po ashtu do të mbahen seminare dhe ese të ndryshme, të cilat do të prezantohen në mënyrë individuale por edhe grupore, dhe teste të vetëvlerësimit. Gjithashtu studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe rezultateve sa më të mira.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Hyrje, Njohja me syllabusin, metoda, organizimi, kërkesat dhe Detyrat e filozofisë. Dohitë e filozofisë e vlerësimi. Shqyrtime të përgjithshme: Filozofia si dukuri mbarë njerëzore. Motivet e filozofisë. Detyrat e filozofisë. Dohitë e filozofisë

Literatura: Dr. Zija Abdullahu, *Hyrje në filozofi.*, f. 3- 21. (Në vazhdim do të jetë kjo literaturë bazë, andaj do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve).

Java e dytë: Koncepti e filozofisë në: Lindjen e Lashtë, Greqinë e Lashtë, në rrethin Islam, në mesjetë dhe në kohën moderne. Klasifikimi i filozofisë: Klasifikimi në Greqinë e Lashtë, te muslimanët, në filozofinë moderne.

Bisedë interaktive, duke krahasuar këto koncepte njëri me tjetrin.

Literatura: (f. 21-39)

Java e tretë: Relacioni i filozofisë me fushat tjera të njohurisë. Shkenca dhe filozofia. Filozofia dhe historia e filozofisë. Filozofia dhe religjioni. Tematikat e filozofisë: Epistemologjia (teoria e njohurisë), ontologjia (teoria ekszistencialiste), dhe teoria e vlerave. Epistemologjia: Mundësia e njohurisë, Natyra e njohurisë.

Diskutim rreth tematikave të filozofisë së përgjithshme dhe asaj islame.

Literatura: (f. 40-61)

Java e katërt: Llojet e njohurisë. Epistemologjia empirike. Pikëpamja islame mbi empirizmin. Epistemologjia idealiste. Doktrina kritike. Pikëpamjet islame mbi idealizmin.

Propozim i temave seminarike

Literatura: (f. 62-73).

Java e pestë: Epistemologjia frymëzuse (sufiste). Mënyrat e njohurisë së metodologjinë frymëzuse. Ontologjia. Kuptimi i ontologjisë dhe metafizikës.

Debat rreth epistemologjisë frymëzuese dhe ndërmjet rrymave të ndryshme.

Literatura: (f. 68-85).

Java e gjashtë: Dy rryma të ndryshme ontologjike. Doktrina materialiste. Materializmi i lashtë, dhe ai modern. Analiza e rezultateve të testit të mbajtur, dhe bisedë interaktive rreth paraqitjes së materializmit.

Literatura: (f. 86-102).

Java e shtatë: Materializmi i lashtë, dhe ai modern. Materializmi dialektik.

Testi i parë, studentët do të ndahen në dy grupe për mbajtjen e testit të parë.

Literatura: (f. 95-110)

Java e tetë: Iluzioni i materializmit. Qëndrimet islame rreth materializmit dialektik.

Debat rreth pikëpamjeve materialiste në rryma të ndryshme filozofike

Literatura: (f. 111-116).

Java e nëntë: Hyrje në filozofinë islame. Filozofia dhe religjioni. Paraqitja e filozofisë islame dhe relacioni i saj me filozofinë greke. Filozofia arabe apo islame. Raporti i filozofisë islame me shkencat tjera islame; me kelamin, tesavufin, fikhun.

Literatura: Ahmed Fuad el-Ahavani, *Filozofia islame*, përktheu: Ismail Bardhi, Shkup, 2002; f. 13- 34. (*Në vazhdim do të jetë kjo literaturë bazë, andaj do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve*).

Java e dhjetë: Filozofia islame në Arabinë Lindore. Përfaqësuesit më eminent të filozofisë islame në Arabinë Lindore. el-Ki El-Farabi, Ibën Sina, Ebu Bekr err-Rrazi, el-Gazali. Bisedë rreth kontributit të tyre në filozofi dhe shkenca tjera islame.

Literatura: (f. 35-71)

Java e njëmbëdhjetë: Filozofia islame në Arabinë Perëndimore. Jeta intelektuale në magribin islam. Përfaqësuesit më eminent të filozofisë islame në Arabinë Lindore. Ibën Baxhe, Ibën Tufejli, Ibën Hazmi.

Përsëritje nga orët e mëparshme.

Literatura: (f. 71-90).

Java e dymbëdhjetë: Ibën Rushdi, Ibën Halduni. Temat më të rëndësishme në filozofinë islame; Allahu, bota, njeriu. Bisedë interaktive mbi pikëpamjet islame rreth empirizmit.

Literatura: (f. 91-125).

Java e trembëdhjetë: Çështje filozofike: Çështja e ekzistencës dhe kuditetiti dhe ontologjisë në filozofinë islame. Kuptimi i *vuxhudit* dhe *mahijes*. Dallimi ndërmjet *vuxhudit* dhe *mahijes*. Çështja e “aksidentshmërisë” së *vuxhudit*. Domosdoshmëria, kontigjenca, pamundësia. Koncepti dhe realiteti i *vuxhudit*. Uniteti, gradimi dhe përparësia e *vuxhudit*. Struktura e realitetit. Përjetimi i *vuxhudit*.

Literatura: Sejjid Hussein Nasr, *Filozofia islame nga zanafilla e saj deri më sot*, përktheu: Edin Q. Lohja, Tiranë, 2011, (f. 79-104). (Në vazhdim do të jetë kjo referencë andaj do të cekim vetëm nr. e faqeve).

Java e katërbëdhjetë: Filozofia islame pas-avicenase dhe studimi i qenies. Çështje epistemologjike: raportet mes intelektit, arsyes dhe intuitës në perspektivat e ndryshme filozofike islame.

Debat rreth paraqitjes së materializmit, dhe shkaqet e tij.

Literatura: (f. 105-126).

Java e pesëmbëdhjetë: Konceptet filozofike moderne islame. Tendencat racionaliste, përfaqësuesit: Ahmed Emin, el-Hejkel, Malik ibën Nebij, el-Mevdudi, en-Nedevi Tendencat reformiste filozofike, përfaqësuesit: Mustafa Abdurrazik, Muhammed el-Behij, Ibrahim Medkur. Abdurrahman el-Bedevi.

Testi përfundimtarë, studentët do të ndahen në dy grupe për mbajtjen e këtij testit.

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Dr. Zija Abdullahu, *Hyrje në filozofi.*, f. 3- 11. (Në vazhdim do të jetë kjo literaturë bazë, andaj do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve).

2. Ahmed Fuad el-Ahavani, *Filozofia islame*, përktheu: Ismail Bardhi, Shkup, 2002; f. 13- 17. (Në vazhdim do të jetë kjo literaturë bazë, andaj do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve).
3. Sejjid Hussein Nasr, *Filozofia islame nga zanafilla e saj deri më sot*, përktheu: Edin Q. Lohja, Tiranë, 2011, (f. 79-87). (Në vazhdim do të jetë kjo referencë andaj do të cekim vetëm nr. e faqeve).

Literartura konsultative:

1. Sulejmani, Dr. Sejjedin, *Filozofia*, Shkup, 1987
2. Hersh, Zhanë, *Habia filozofike*, përktheu: Artan Fuga, Tiranë, 1993
3. Gadamer, Hans-George, *Historia e filozofisë*, përktheu: Alda Mukli, Tiranë, 2008